

Roli i të Rinjve
në
Subjektet Politike
në Kosovë
Korrik 2016



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA





Roli i Rinisë në Subjektet Politike

Të drejtat e autorit © 2016 Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES).

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklaratë e lejes: Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, elektronike ose mekanike, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo me ndonjë sistem për ruajtje dhe nxjerrje të informatave pa lejen me shkrim të IFES-it.

Në kërkesat për leje duhet të përfshihen informatat e mëposhtme:

- Përshkrimi i materialit për të cilën dëshirohet leja për kopjim.
- Qëllimin për të cilin do të përdoret materiali i kopjuar dhe mënyra në të cilën do të përdoret.
- Emri juaj, titulli, emri i kompanisë apo organizatës, numri i telefonit, numri i faksit, e-mail adresa dhe adresa e postës.

Ju lutem dërgoni të gjitha kërkesat për autorizimin tek:

International Foundation for Electoral Systems
2011 Crystal Drive, Floor 10
Arlington, VA 22202
E-mail: editor@ifes.org
Fax: 202-350-6701

Ky raport është mundësuar me përkrahjen bujare të popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorit(ëve) dhe jo domosdoshmërisht i pasqyrojnë pikëpamjet e USAID apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja

Tabela e shkurtesave	2
A. Përmbledhje ekzekutive.....	3
B. Hyrje.....	4
C. Metodologjia	4
D. Gjetjet	6
1. Pikëpamjet e rinisë në përgjithësi	6
2. Pikëpamjet e organizatave të shoqërisë civile	10
3. Pikëpamjet e anëtarëve të strukturave rinore të subjekteve politike.....	12
E. Përfundim.....	14
F. Rekomandime	15
G. Shembuj të Rinisë Aktive	16
Shtojca I: Ekstrakte nga ligji i Kosovës.....	18
Shtojca II: Të referuarit në rininë tek statutet e subjekteve politike.....	19
Shtojca III: Lexim plotësues	20

Tabela e shkurtesave

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
D4D	Demokracia për Zhvillim
FOL	Lëvizja Fol
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
NISMA	Nisma për Kosovën
PDAK	Partia Demokratike e Ashkalijve të Kosovës
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PD	Partia e Drejtësisë
SLS	Partia e Pavarur Liberale
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VV	Lëvizja Vetëvendosje

A. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport përfshinë informata mbi rolin e të rinjve në subjekte politike dhe organizatat rinore siç shihen nga këndvështrimi i të rinjve në përgjithësi, përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, dhe të rinjve të cilët aktualisht janë anëtar të strukturave rinore të subjekteve politike. Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë mbledhur përmes anketimeve të drejtpërdrejta me rininë, takimeve dhe intervistave telefonike. Në vijim paraqiten gjetjet kryesore:

- Shtatëdhjetë e tre përqind e të rinjve të anketuar nuk kanë qenë asnjëherë anëtarë të strukturave rinore të ndonjë subjekti politik apo organizate rinore, 17 përqind kishin qenë por nuk janë më anëtarë, dhe vetëm 10 përqind janë aktualisht anëtarë të strukturave rinore të subjekteve politike apo organizate rinore;
- Katërdhjetë e një përqind e rinisë së anketuar ishin të pakënaqur me rolin e rinisë në subjektet politike, ndërsa 35 përqind ishin të kënaqur. Të anketuarit të cilët aktualisht janë anëtarë të strukturave rinore në subjekte politike apo organizata rinore kanë më tepër gjasa të jenë të kënaqur;
- Përfitimet personale ishin përgjigjet kryesore nga rinia e anketuar kur janë pyetur për përfitimet e anëtarësimit në subjektet politike. Më shpesh të përmendura ishin që anëtarësia në një subjekt politik do të ndihmonte të gjejnë punësim (48%) dhe do të ndihmonte të zhvilloheshin profesionalisht (36%);
- Njëzet e tetë përqind e rinisë së anketuar theksuan se asnjë subjekt politik nuk ka ideologji që është e ngjashme me pikëpamjet të tyre;
- Përfaqësuesit kyç nga shoqëria civile ishin të mendimit që strukturat rinore të subjekteve politike nuk luajnë ndonjë rol në proceset vendim-marrëse në subjektet politike, dhe se rinisë ju ofrohen detyra sipërfaqësore administrative në veçanti gjatë fushatave zgjedhore. Ata i vunë theks të veçantë lidhjes në mes anëtarësisë në strukturat rinore dhe mundësive të punësimit, gjë që e fuqizon gjetjen paraprake nga ky raport;
- Sipas përfaqësuesve kyç nga shoqëria civile, përparësitë e anëtarësimit të të rinjve në subjekte politike janë që të rinjtë mësojnë lidhur me zhvillimet politike, kuptojnë më mirë partitë politike dhe institucionet, përgatiten të bëhen politikanë, dhe mund të punësohen. Në anën tjetër, këta përfaqësues gjithashtu besojnë që anëtarësimi mund ta dekurajoj rininë që të mendojë në mënyrë jo-partiake, dhe anëtarësimi mund të perceptohet si jo-profesional;
- Anëtarët e intervistuar të strukturave rinore të subjekteve politike, në mesin e arsyeve të tjera, deklaruan se vendosën të bëhen anëtarë për shkak që: të ketë një të ardhme më të mirë, të ndihmojnë strukturën rinore në zbatimin e aktiviteteve, të jenë më afër politikës, të kontribuojnë në zhvillimin e Kosovës, dhe të jenë pjesë e një strukture rinore që shikohej si shpresë për ndryshime. Anëtarët e strukturave rinore nuk e çekën punësimin si arsye për anëtarësimin e tyre;
- Anëtarët e intervistuar në strukturat rinore deklaruan se ishin të kënaqur me angazhimin e tyre në strukturat rinore dhe në proceset vendim-marrëse të subjekteve politike. Ata theksuan që aktivitetet e strukturave rinore janë të zgjeruara në aktivitete rekreative, humanitare dhe arsimore. Anëtarët e subjekteve politike opozitare ishin të angazhuar edhe në organizimin e protestave të mbajtura rishtazi.

B. Hyrje

Rinia përbën një pjesë të konsiderueshme të popullatës së Kosovës. Regjistrimi i popullatës në vitin 2011 tregoi se pothuajse një e treta (27%) e popullatës i përket moshës 15 deri 29 vjeç. Ekziston një mungesë e hulumtimeve mbi çështjen e anëtarësimit të rinjve në subjekte politike dhe organizata rinore, ndërsa ka nevojë të hulumtohet se deri në çfarë niveli rinia është e kyçur dhe nëse ka ndikim në proceset vendim-marrëse të këtyre subjekteve politike.

Gjatë vitit 2012, Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) realizoi një studim me mbi 1,200 pjesëmarrës nga e gjithë Kosova, ku është gjetur se rreth 90 përqind e rinisë prej moshës 18 deri në 25 nuk kishin qenë kurrë anëtarë të ndonjë subjekti politik, organizate jo-qeveritare, organizate rinore apo ndonjë grupi tjetër rinor. Këto shifra tregojnë një distancim në mes rinisë në njërën anë, dhe subjekteve politike dhe organizatave rinore në anën tjetrën. Ky distancim kërkon një hulumtim shtesë lidhur me arsyet se përse ekziston një mungesë në angazhimin e rinisë, si perceptohen subjektet politike dhe organizatat rinore nga rinia, dhe nëse këto subjekte ofrojnë mundësi të mjaftueshme për rininë që t’iu bashkëngjiten dhe të luajnë një rol të caktuar.

Ky raport i paraqet gjetjet mbi rolin e rinisë në subjektet politike dhe organizatat rinore në Kosovë. Pjesa e analizës është e ndarë në tri pjesë, dhe secila nga to paraqet perceptimet e angazhimit të rinjve nga këndvështrimi i: 1) rinisë në përgjithësi; 2) përfaqësuesve kyç të organizatave të shoqërisë civile (OSHC); dhe 3) rinisë që aktualisht janë anëtarë të strukturave rinore të subjektet politike. Secilit prej këtyre tri grupeve u janë bërë pyetje të ngjashme lidhur me rolin e rinisë, për të vlerësuar nivelin e angazhimit të rinisë në proceset vendim-marrëse, sa janë të kënaqur me rolin dhe angazhimin e tyre në zbatimin e aktiviteteve. Ekziston një llojllojshmëri e pikëpamjeve në mes të tri grupeve lidhur me këto çështje, ndërsa lexuesin e inkurajojmë t’i krahasojë këto pikëpamje. Në fund, raporti paraqet përfundimin, rekomandimet dhe disa praktika të mira nga vende të tjera për ngritjen efektive të rolit të rinisë në proceset politike dhe vendim-marrëse. Në shtojca, raporti gjithashtu i referohet kornizës relevante ligjore dhe statuteve të subjekteve politike në Kosovë, si dhe ofron sugjerime të burimeve shtesë lidhur me pjesëmarrjen e rinisë në subjektet politike dhe organizatat rinore.

Ky raport është hulumtuar dhe përgatitur nga studentë¹ të nivelit bachelor të angazhuar në punë praktike hulumtuese si pjesë e programit të IFES-it të financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) “Rritja e Përfshirjes dhe Zvogëlimi i Dhunës në Proceset Elektorale” në Kosovë, nën udhëheqjen e stafit të IFES në Kosovë. Ky raport është njëri nga tri raportet mbi hulumtimet e çështjeve të pjesëmarrjes së rinisë në Kosovë të përgatitura nga IFES gjatë vitit 2016. Dy raportet tjera paraqesin gjetjet mbi pjesëmarrjen e rinisë në votime në Kosovë, dhe ndikimin e gjuhës së urrejtjes në politikë në sjelljet e rinisë.

C. Metodologjia

Ky raport paraqet perceptimet mbi rolin e rinisë në subjektet politike dhe organizatat rinore nga këndvështrimi i rinisë në përgjithësi, i përfaqësuesve të shoqërisë civile, dhe rinisë e cila është anëtare

¹ Endrit Dibrani, Rudinë Fetahaj (Fakulteti i Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”), dhe Fjoralba Krapi and Hana Bacaj (Rochester Institute of Technology Kosovë).

e strukturave rinore të subjekteve politike. Metodat kuantitative dhe kualitative janë përdorur për mbledhjen e informatave nga këto grupe.

Së pari, për të siguruar informata nga rinia në përgjithësi, një anketë me mostër sistematike është realizuar me 300 të anketuar të moshës nga 15 deri në 29 vjeç. Kjo grup-moshë përdoret në definicionin e rinisë nga USAID. Këto intervista ballë-për-ballë janë zhvilluar në pesë rajone të Kosovës (Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë, si dhe Skenderaj dhe Glogovc). Pikat e mostrës janë vendosur në ambiente të ndryshme si kafene, institucione arsimore, qendra

Rajoni	Të anketuar	Pika të Mostrës
Prishtina	97	49
Mitrovica	35	18
Prizren	90	45
Peja	48	24
Skenderaj & Glogovc	30	15
TOTAL	300	151

tregtare dhe tregje. Personat që morën pjesë në intervista tek secila pikë e marrjes së mostrave janë përzgjedhur duke përdorur teknika për përzgjedhje të rastësishme. Puna në teren është realizuar gjatë muajve Shkurt dhe Mars në vitin 2016.

Së dyti, për të mbledhur informata nga shoqëria civile, janë realizuar tri takime dhe një intervistë telefonike me përfaqësues të OSHC. Organizatat që janë intervistuar, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Demokracia për Zhvillim (D4D), dhe Lëvizja FOL, ishin përzgjedhur në bazë të përvojës të punës së tyre me subjektet politike dhe organizatat rinore. Gjithashtu, është realizuar një intervistë telefonike me një përfaqësues të BRAN, një organizatë që punon për fuqizimin e komunitetit Ashkali në Kosovë. Takimet dhe intervistat me OSHC janë përfunduar gjatë muajit Mars dhe fillimit të muajit Prill të vitit 2016.

Së treti, për të shtuar edhe pikëpamjen e atyre që janë anëtarë të strukturave rinore përbrenda subjekteve politike, janë zhvilluar nëntë intervista telefonike me anëtarë të strukturave rinore të subjekteve politike, me nga tri anëtarë të ndryshëm të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe NISMA për Kosovën (NISMA). Shumica e të intervistuarave ishin anëtarë të strukturave udhëheqëse rinore të subjekteve politike, dhe disa prej tyre ishin anëtarë pa role udhëheqëse. Përpjekjet për të intervistuar anëtarë të strukturave rinore të disa subjekteve tjera politike, përkatësisht nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia e Drejtësisë (PD) dhe Lista Srpska, ishin të pasuksesshme. Ekipi hulumtues nuk e pa të arsyeshme të intervistoj përfaqësuesit e subjekteve politike që nuk kanë struktura rinore përbrenda strukturave të subjektit politik, dhe për këtë arsye nuk janë intervistuar subjektet politike si Lëvizja Vetëvendosje (VV) dhe Partia Demokratike e Ashkalijve të Kosovës (PDAK). Intervistat telefonike janë realizuar gjatë muajit Mars dhe Prill në vitin 2016.

Ky është një projekt hulumtues i iniciuar nga të rinjtë dhe është realizuar me burime të kufizuara financiare dhe njerëzore. Është zhvilluar vetëm një numër i kufizuar i anketave dhe intervistave përbrenda burimeve të mundësuar, mirëpo metodologjia është dizajnuar në atë mënyrë që të sigurojë rezultate të përdorueshme dhe treguese. Ekipi hulumtues është përballur me pengesa në përgatitjet për intervistat, pasi që disa prej subjekteve politike nuk treguan interesim për të marrë pjesë në këtë hulumtim. Ekipi hulumtues dëshiron të falënderojë të anketuarit, përfaqësuesit e OSHC,

dhe anëtarët e strukturave rinore të cilët ndanë kohën e tyre për intervista, dhe kontribuan në gjetjet që janë paraqitur në këtë raport.


D. Gjetjet

Kjo pjesë e raportit është e ndarë në tri pjesë, dhe secila nga to paraqet gjetjet mbi rolin e rinisë në subjektet politike dhe organizatat rinore siç shihet nga këndvështrimi i: 1) rinisë në përgjithësi; 2) përfaqësuesve kyç të OSHC; dhe 3) rinisë aktualisht anëtare të strukturave rinore të subjekteve politike.

1. Pikëpamjet e rinisë në përgjithësi


Në përgjithësi, të anketuarit vlerësuan si të rëndësishëm angazhimin e rinisë në subjekte politike. Afër dy të tretat (60%) e të anketuarve besojnë që është pjesërisht apo shumë e rëndësishme për rininë të jetë pjesë e subjekteve politike në Kosovë. Kjo mund të shikohet si njëra prej mënyrave përmes të cilës mund të kyçësh në jetën politike. Megjithatë, ekziston një pjesë e konsiderueshme e atyre që mendojnë se anëtarësimi i rinisë në subjekte politike nuk është i rëndësishëm (9%), apo aspak i rëndësishëm (18%) (Figura 1). Si të anketuarit meshkuj ashtu edhe femrat kishin pikëpamje të ngjashme mbi rëndësinë e anëtarësisë së rinisë në subjekte politike.

Figura 1: Sa është e rëndësishme për rininë që të jetë anëtarësohet në subjektet politike në Kosovë



Edhe pse të anketuarit vlerësuan si të rëndësishëm anëtarësinë e rinisë në subjekte politike, ata nuk e shohin vetën të angazhuar në këto subjekte (Figura 2). Afër tri të katërtat (73%) e të anketuarve nuk kishin qenë asnjëherë anëtarë të strukturave rinore të subjekteve politike apo organizatave rinore. Vetëm 10 përqind e të anketuarve janë aktualisht anëtarë të ndonjë strukture rinore apo organizate rinore. Të anketuarit nga zonat rurale kanë dyfish më shumë gjasa të jenë të angazhuar në strukturat rinore të subjekteve politike apo organizatave rinore sesa të anketuarit në zonat urbane. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (17%) kishin qenë anëtarë të një strukture rinore të subjektit politik apo organizate rinore në të kaluarën, mirëpo nuk janë më anëtarë. Kjo është hasur më e shpesh tek pjesëmarrësit në zonat urbane. Sa i përket kësaj çështje, nuk kishte gati aspak ndryshim në mes të anketuarve meshkuj dhe femra.


Figura 2: A jeni anëtarë i ndonjë strukture rinore të ndonjë subjekti politik apo organizate rinore



Të anketuarit ofruan arsye të ndryshme se përse nuk u ishin bashkangjitur asnjëherë këtyre subjekteve. Në përgjithësi, të anketuarit kishin përshtypjen se nuk kishte mundësi të mjaftueshme apo nxitje për tu angazhuar. Nga ata që dhanë arsye, 41 përqind deklaruan se nuk kishin qenë të interesuar për tu bashkangjitur. Arsyet e tjera të vetme të dhëna nga një numër i konsiderueshëm i të anketuarve ishin se anëtarësimi nuk do të rezultojë në ndonjë gjë pozitive (9%), dhe se nuk mbështetnin asnjë subjekt politik (9%). Mbi një e katërta (27%) e të anketuarve të cilët asnjëherë nuk u ishin bashkangjitur këtyre subjekteve, nuk dhanë ndonjë arsye.

Nga pjesëmarrësit të cilët aktualisht janë, apo të cilët kanë qenë mirëpo nuk janë më anëtarë të subjekteve politike apo organizatave rinore, shumica dërmuese janë apo kanë qenë të angazhuar në subjekte politike. Vetëm 8 përqind janë apo kanë qenë të angazhuar në organizata rinore. Në mesin e atyre që janë apo ishin të angazhuar në subjekte politike, 26 përqind janë apo kanë qenë anëtarë të LDK, 25 përqind të PDK, 20 përqind të VV, 15 përqind të AAK, dhe të tjerët ishin të angazhuar në parti më të vogla (Figura 3).

Figure 3: Anëtarësia e të rinjve në organizata rinore dhe struktura rinore të subjekteve politike, dhe ndarja sipas subjekteve politike




Rezultatet e studimit tregojnë që ekziston një ndarje në mes të pikëpamjeve së të anketuarve lidhur me nivelin e kënaqshmërisë me rolin e rinisë në strukturat e subjekteve politike në Kosovë. Më tepër se një e treta (35%) e të anketuarve ishin të kënaqur me rolin e rinisë në strukturat e subjekteve politike. Ata besojnë që angazhimi në strukturat e subjekteve politike i mundëson të rinjve të fitojnë përvojë, të angazhohen në aktivitetet e subjekteve politike, të krijojnë rrjete më të mira dhe të sjellin

ide të reja në subjektet e tyre politike. Megjithatë, kishte një pjesë pak më të madhe (41%) të të pakënaqurve. Arsyet kryesore për pakënaqësi përfshijnë ato që rinia nuk ka ndonjë rol të caktuar në subjekte politike, rinia nuk ka ndikim në vendim-marrje, keqpërdorimi i pushtetit, organizatat nuk janë aktive lidhur me interesat e rinisë, dhe se rinia ishte e angazhuar vetëm me detyra minimale administrative.


Nuk është e befasishme që të anketuarit të cilët aktualisht janë anëtarë të strukturave rinore të subjekteve politike apo organizatave rinore kanë shumë më tepër gjasa të jenë të kënaqur me rolin e rinisë në strukturat e subjekteve rinore sesa ata që në të kaluarën kanë qenë anëtarë, por aktualisht nuk janë anëtarë, të cilët kanë tendencë të jenë tejet të pakënaqur (Figura 4). Të anketuarit të cilët asnjëherë nuk kishin qenë anëtarë, janë ose të kënaqur ose të pakënaqur në mënyrë proporcionale, mirëpo një pjesë e konsiderueshme e këtyre të anketuarve nuk ishin në gjendje të përgjigjeshin në këtë pyetje.

Figura 4: Kënaqshmëria e anëtarëve të tanishëm, ish-anëtarëve, si dhe atyre që asnjëherë nuk kanë qenë anëtarë, me rolin e rinisë në subjektet politike



Kishte pikëpamje të llojllojshme në mesin të anketuarve sa i përket mundësive të rinisë për të marrë pjesë në proceset e vendim-marrjes në subjekte politike. Në përgjithësi ekziston një përqindje pothuajse e barabartë në mes të atyre që besojnë se mundësitë janë të kënaqshme (40%) dhe atyre që besojnë se mundësi të tilla janë të pa kënaqshme (38%). Të anketuarit në zonat rurale besojnë se mundësitë për rininë që të jetë e kyçur në vendim-marrje janë të kënaqshme dyfish më shumë sesa ata nga zonat urbane (Figura 5). Ekzistojnë perceptime të ngjashme në mes të anketuarve meshkuj dhe femra lidhur me mundësitë e rinisë për të marrë pjesë në vendim-marrje në subjekte politike. Të anketuarit që i përkasin moshave 15 deri në 22 vjeç besojnë më shumë që ka mundësi të kënaqshme për të marrë pjesë në vendim-marrje tek subjektet politike, sesa të rinjtë nga 22 deri në 29 vjeç.

Figura 5: Mundësitë e rinisë për përfshirje në procesin vendim-marrës brenda subjektet politike



Perceptimi i të anketuarve tregon se ekziston një lidhje në mes anëtarësimit në një subjekt politik dhe mundësisë për sigurim të punësimit. Është kërkuar nga pjesëmarrësit të ofrojnë përgjigje të shumëfishta lidhur me atë se si anëtarësia në një subjekti politik apo strukturë rinore i ndihmon njerëzve të ri në jetën e tyre. Pjesëmarrësit kishin më shumë gjasa të pajtoheshin me atë se anëtarësimi i ndihmon të rinjve në sigurimin e punësimit (48%), ndihmon në zhvillimin profesional (36%), ngrit vetëdijesimin e të rinjve lidhur me atë që ndodh në Kosovë (32%), bënë që zëri i tyre të dëgjohet (32%), dhe i përgatit për tu bërë politikanë (25%) (Figura 6). Shumë pak nga të anketuarit mendonin që anëtarësimi në një subjekt politik apo organizatë rinore nuk ndihmon fare.

Përfitimet personale ishin nga më të spikaturat në mesin e pikëpamjeve të anketuarve mbi përfitimet e anëtarësimit në një subjekt politik, në veçanti lidhur me sigurimin e punësimit, zhvillimin profesional dhe shoqërimin me njerëz që kanë pushtet. Pjesëmarrësit kishin më tepër gjasa ta shihnin anëtarësimin në parti si një mjet për arritjen e qëllimeve personale, dhe më pak gjasa si mjet për zbatimin e programeve politike që do trajtonin çështje shoqërore.

Figura 6: Anëtarësia në një subjekt politik apo organizatë rinore e ndihmon një person të ri që të: (përgjigjet e shumëfishta lejohen)

Sigurojë një punë	48%
Zhvillohet profesionalisht	36%
Vetëdijësohet në atë se çka po ndodhë në Kosovë	32%
Sigurojë që zëri i të rinjve po dëgjohet	32%
Përgatitet për t'u bërë politikan	25%
Krijojë marrëdhënie me njerëz të cilët kanë pozita në pushtet	23%
Ftohet në ahengje dhe mbledhi shoqërore	21%
Përfshihet në procesin e vendimmarrjes në Kosovë	18%
Sigurohet se komuniteti pajiset me shërbimin e duhur	13%
Nuk ndihmon në asnjë mënyrë	6%
Të tjera	5%
Nuk e di/Nuk kam përgjigje	2%

Kishte disa dallime në pikëpamjet e të anketuarve lidhur me mënyrat se si të rinjtë mund të marrin pjesë në proceset e vendim-marrjes në Kosovë tani, në krahasim me të ardhmen (Figura 7). Në një pyetje me mundësi përgjigje të hapur, të qenit aktiv në parti politike apo politikë (19%), dhe pjesëmarrja në protesta (19%) ishin dy prej mënyrave aktuale që u përmenden më së shpeshti si forma për të marrë pjesë në vendim-marrje. Dymbëdhjetë përqind e të anketuarve besojnë që momentalisht nuk ka mundësi efektive për rininë që të merr pjesë në proceset vendim-marrëse. Ishte rreth një e pesta e të anketuarve të cilët nuk cekën asnjë mënyrë për të marrë pjesë në vendim-marrje.

Figura 7: Mënyrat më shpesh të cekura për pjesëmarrje në proceset vendim-marrëse aktualisht, si dhe në të ardhmen (përgjigjet e shumëfishta lejohen)

	Aktualisht	Në të ardhmen
Të qenit aktiv në subjekte politike/politikë	19%	→ 25%
Të qenit aktiv në OJQ	6%	→ 5%
Angazhimi në projekte dhe organizata	7%	→ 5%
Promovimi i ideve të reja	5%	→ 4%
Të qenit aktiv përmes takimeve dhe peticioneve	5%	→ 2%
Pjesëmarrja në protesta	19%	→ 6%
Të arsimohemi më mirë	4%	→ 22%
Nuk ka mundësi efektive	12%	→ 0%
Mundësi më të mira punësimi	0%	→ 6%

Megjithatë, të anketuarit kanë pikëpamje tjera dhe më optimiste lidhur me mënyrat se si të rinjtë mund të marrin pjesë në proceset vendim-marrëse në të ardhmen. Kjo më së miri shihet tek rritja e nivelit të të anketuarve të cilët e shohin arsimimin si një mënyrë e pjesëmarrjes në vendim-marrje në të ardhmen, dhe trendin pozitiv tek ata që veçuan të qenit aktiv në subjekte politike apo politikë. Në anën tjetër, në krahasim me pikëpamjet lidhur me mënyrat e pjesëmarrjes tani, të anketuarit kishin më pak gjasa të shihnin pjesëmarrjen në protesta si një mënyrë për të marrë pjesë në vendim-marrje në të ardhmen. Asnjë i anketuar nuk mendoi që në të ardhmen nuk do të ketë mundësi efektive për rininë të marr pjesë në vendim-marrje. Megjithatë, një në pesë të anketuar nuk ishte në gjendje të përgjigjej në këto pyetje, si për situatën e tanishme ashtu edhe për të ardhmen. Në përputhje me përgjigjet në pyetjet paraprake mbi anëtarësimin në entitete, kjo tregon për një mungesë të angazhimit shoqëror nga një pjesë e konsiderueshme e të rinjve. Kishte proporcione të ngjashme të meshkujve dhe femrave të anketuar lidhur me mënyrat e pjesëmarrjes tani dhe në të ardhmen.

Kur të anketuarit u pyeten se cili subjekt politik kishte ideologji të ngjashme me pikëpamjet e tyre, mbi një e katërta (28%) e të anketuarve u përgjigjen se asnjë nga subjektet politik nuk kishte ideologji të ngjashme me pikëpamjet e tyre. Më tej, 16 përqind të të anketuarve nuk preferuan të përgjigjen në këtë pyetje.

2. Pikëpamjet e organizatave të shoqërisë civile

Disa nga përfaqësuesit kyç të OSHC të intervistuar bënë lidhjen në mes strukturave rinore aktuale të subjekteve politike me ato të strukturave të partisë komuniste në ish Jugosllavi, dhe theksuan se struktura të tilla tradicionalisht janë përdorur si mekanizma përmes të cilave rinia është rekrutuar dhe angazhuar në jetën politike. Megjithatë, ata pranuan që popullata e Kosovës është relativisht e re, dhe

se subjektet politike mund të nxiten për shfrytëzimin e këtyre strukturave për të qenë më joshëse për rininë.

Përfaqësuesit kyç të OSHC nuk vënë në pyetje arsyet për ekzistimin e strukturave rinore tek subjektet politike, por shprehën brengat e tyre lidhur me rolin dhe ndikimin e rinisë në proceset vendim-marrëse të një subjekti politik. Nga këndvështrimi i tyre, strukturat rinore shërbejnë si mekanizma simbolike përmes të cilave subjektet politike mbulojnë për mungesën e përfaqësimit të rinisë në strukturat udhëheqëse të subjekteve, dhe për programet jo-adekuate që trajtojnë interesat e rinisë. Zakonisht, partitë mund t'i kyçin kryesuesit e strukturave rinore në strukturat udhëheqëse të partisë, mirëpo vendimet merren nga liderët më të vjetër partiak. Këta përfaqësues kyç rekomandojnë që rinia të jetë më këmbëngulëse brenda partive politike, të tregojnë integritetin dhe vlerat e tyre, pasi që ata kanë fuqinë që të bëjnë ndryshime në mënyrën sesi partitë politike qeverisin vetveten.

Përfaqësuesit kyç të OSHC shprehën brengat e tyre se rinisë i caktohen vetëm detyra minimale administrative gjatë periudhave të fushatave. Kjo brengë ishte shprehur gjithashtu në mesin e të rinjve të anketuar, të cilët cekën angazhimin e rinisë në detyra minimale administrative si një prej arsyeve përse ishin të pakënaqur me rolin e rinisë në subjektet politike. Sipas përfaqësuesve kyç të OSHC, rinia përdoret për shpërndarjen e materialeve për promovim (afishe, broshura), sigurimin e votave, vëzhgimin e Ditës së Zgjedhjeve, dhe krijimin e turmës së nevojshme për ngjarjet e fushatave. Përfaqësuesit kyç të OSHC ishin të mendimit që nganjëherë strukturat rinore nuk duken serioze, duke ju referuar shembujve kur strukturave rinore u ishin dhënë detyra të i presin të ardhurit nga diaspora në aeroport dhe të shpërndajnë *bakllavë* për ta, apo të lirojnë pëllumba për të fluturuar në bulevardet kryesore.

Përfaqësuesit kyç të OSHC vënë theks të veçantë tek marrëdhënia në mes anëtarësimit në struktura rinore dhe mundësive për punësim, që e mbështet gjetjen e mëparshme të studimit që të anketuarit kishin më tepër gjasa të pajtoheshin se anëtarësimi në një subjekt politik do të ndihmonte të rinjtë të siguronin punë. Këta përfaqësues ishin të mendimit që subjektet politike i premtojnë rinisë vende pune në sektorin publik, posaçërisht nëse subjekti politik i tyre i fiton zgjedhjet. Mendimi i tyre është që, zakonisht, do të jetë vetëm kryesuesi i strukturës rinore i cili do të punësohet në një pozitë publike, dhe do të ketë mundësi të avancohet në karrierë.

Në përgjithësi, përfaqësuesit kyç të OSHC besojnë që ekzistojnë disa arsye që mund të inkurajojnë rininë për t'u bërë anëtarë të strukturave rinore dhe subjekteve politike. Këto përfshijnë idolizimin e liderit partiak, ndikimin nga familja, dëshirën për t'u bërë politikan, dhe mundësitë më të mira të punësimit. Megjithatë, ata gjithashtu theksuan se ekzistojnë një numër faktorësh që mund ta largojnë rininë, përfshirë frikën e identifikimit me një parti politike nga të tjerët, që mund të jetë e kushtueshme varësisht nga sukcesi i subjektit politik në zgjedhje. Kjo brengë ishte ngritur gjithashtu në hulumtimet paraprake të IFES lidhur me përfshirjen e femrave në trupat e menaxhuese të zgjedhjeve, ku ishte gjetur se gratë në përgjithësi hezitonin të lidheshin me subjektet politike, pasi që punësimi i tyre do të ndikohej posaçërisht nëse subjekti i tyre politik nuk do i fitonte zgjedhjet.

Sipas përfaqësuesve kyç të OSHC, anëtarësimi në strukturat rinore të subjekteve politike vjen me përfitime dhe kosto njëkohësisht. (Figura 8).

Figura 8: Perceptimet e përfaqësuesve kyç të OSHC mbi përparësitë dhe mangësitë e anëtarësimit të rinisë në subjektet politike

Përparësitë	Mangësitë
- Mësojnë lidhur me zhvillimet politike - Kuptojnë më mirë funksionimin e subjekteve politike dhe institucioneve - Përgatiten për jetën politike - Mundësi punësimi	- Dekurajon rininë për të menduar në mënyrë jo-partiake - Nëse anëtarësohen, shikohen sikur mbajnë qëndrime të njëanshme dhe jo-profesionale - Rinia mund të zhgënjehet me atë që gjenë brenda subjekteve politike

Përfaqësuesit e OSHC ishin të mendimit që Kosova mund të mësojë nga Britania e Madhe, ku partitë politike themelojnë degë si organizata studentore, të cilat pastaj punojnë për t'i bashkuar studentët me pikëpamje të njëjta politike, dhe të përmirësojnë qasjen e tyre në proceset vendim-marrëse. Kjo ishte rekomanduar nga ata si një nga mënyrat përmes të cilës subjektet politike në Kosovë mund t'i qasen rinisë, dhe të sjellin ide të reja tek subjekti.

3. Pikëpamjet e anëtarëve të strukturave rinore të subjekteve politike

Anëtarët e strukturave rinore të cilët janë intervistuar veçuan arsye të shumta përse ata vendosën të bëhen anëtarë të strukturave rinore, përfshirë: të kenë një të ardhme më të mirë, të ndihmojnë strukturën rinore në zbatimin e aktiviteteve, të jenë më afër politikës, të kontribuojnë në zhvillimin e Kosovës, dhe të jenë pjesë e një strukture rinore që shihet si shpresë për ndryshim. Idolizimi i liderit partiak gjithashtu është cekur. Në kundërshtim me pikëpamjet e shprehura nga rinia e anketuar dhe nga përfaqësuesit kyç të OSHC, qasja në mundësi punësimi nuk ishte në mesin e arsyeve për anëtarësim në subjekte politike sipas anëtarëve të intervistuar të strukturave rinore.

Nga përshkrimi i dhënë nga anëtarët e strukturave rinore të cilët u intervistuan, strukturat rinore të PDK, AAK dhe NISMA duken pothuaj të ngjashme në mënyrën se si i angazhojnë anëtarët e ri në aktivitetet e tyre. Anëtarët e këtyre strukturave rinore kanë të drejtën të propozojnë aktivitete dhe iniciativa përbrenda strukturave rinore.

Ka gjithashtu disa dallime në mënyrën se si këto struktura rinore funksionojnë dhe marrin vendime. Të intervistuarit nga NISMA deklaruan se udhëheqësia e strukturës rinore të tyre (Kryesuesi, dy Zëvendës Kryesues dhe Sekretari) takohen së paku çdo javë, dhe përkundër se vendimet merren bashkërisht dhe unanimisht nga udhëheqësia, të gjithë anëtarët konsultohet rregullisht. Ata organizojnë tryeza të rrumbullakëta për të diskutuar problemet shoqërore.

Përfaqësuesit e strukturës rinore të PDK theksojnë se vendimet e Rinisë Demokratike merren me shumicën e dy të tretave të gjithë anëtarëve. Momentalisht janë 31 anëtarë. Të gjithë anëtarët kanë të drejtën të propozojnë ide për aktivitete rinore dhe të marrin ndonjë iniciativë. Siç thuhet nga këta përfaqësues, ekziston edhe një grup i vullnetarëve të ri të cilët janë të integruar në PDK dhe janë të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve, por që nuk marrin pjesë në vendim-marrje.

Të intervistuarit nga struktura rinore e AAK-së nuk ofruan shumë informata lidhur me mënyrën se si struktura rinore vepron. Ata theksuan se struktura rinore është një departament i veçantë i partisë, ka një udhëheqësi të përbërë nga Kryesuesi, dy Zëvendës Kryesues dhe Sekretar, dhe se anëtarët kanë pavarësinë të vendosin vetë pa ndikimin e liderëve partiak.

Këta anëtarë të subjekteve politike përmendën disa aktivitete të cilat i zbatojnë në kuadër të strukturave rinore. Rinia nga PDK theksoi se kishte zbatuar mbi 50 aktivitete gjatë dy viteve të fundit, disa prej të cilave përfshinin pastrimin e ujëvarës Mirusha, aktivitete bamirësie për t'i ndihmuar familjet në nevojë gjatë festave të Vitit të Ri, ngjarje sportive për të ri, riparimin e përmendores së Gjergj Kastriot Skënderbeut, dhe aktivitetet të tjera që promovojnë turizmin në nivel lokal.

Rinia nga NISMA theksoi se ishin të angazhuar në organizimin e protestave, dhe avokimin për liberalizimin e vizave. Në të ardhmen, ata planifikojnë të hartojnë një buxhet për strukturën rinore, të organizojnë kurse leximi, dhe të zhvillojnë kurse pa pagesë për gjuhë të huaja. Rinia nga AAK theksoi se ishte e angazhuar për t'i ndihmuar komuniteteve gjatë vërshimeve, organizimin e aktiviteteve të futbollit, dhe shpërndarjen e afisheve për kandidat. Ata gjithashtu cekën se aktivitetet e tyre të rregullta në strukturën rinore janë ndaluar së fundmi, pasi që kanë qenë të angazhuar në organizimin e protestave. Rinia në të gjitha partitë ngriti shqetësime se aktivitetet e strukturave rinore ishin të kufizuara nga mungesa e financimit.

Nga informatat e ofruara nga këta të intervistuar, shumica e aktiviteteve që zbatohen nga strukturat rinore duken të jenë jashtë fushëveprimit dhe angazhimit të tyre politik, dhe nuk duket se kyçin rininë në proceset vendim-marrëse të subjektit politik. Megjithatë, kur u pyeten lidhur me mendimin e tyre mbi nivelin e përfshirjes së strukturës rinore në proceset vendim-marrëse, në përgjithësi të intervistuarit besojnë që kanë një përfshirje të arsyeshme në këto struktura. Kur u kërkua nga ta që të japin vlerësimin në shkallë prej 10 pikëve, "Deri në çfarë niveli besoni se struktura rinore është e përfshirë në vendim-marrjen e subjekti politik" ku një është aspak e përfshirë, ndërsa dhjetë është shumë e përfshirë, vlerësimi mesatar ishte shtatë. Niveli i vlerësimit të përfshirjes nga të intervistuarit e rinjë të PDK-së ishte pak më i lart sesa nga ata prej NISMA dhe AAK.

Anëtarët e intervistuar të strukturave rinore dukeshin të kënaqur me përfshirjen e tyre në strukturat rinore të subjekteve politike. Kur u kërkua nga ta të vlerësojnë me një shkallë prej 10 pikëve, 'Sa jeni të kënaqur me përfshirjen tuaj në strukturën rinore' ku një është aspak të kënaqur ndërsa dhjetë shumë të kënaqur, mesatarja ishte nëntë.

E. Përfundim

Ky raport paraqet pikëpamjet e rinisë në përgjithësi, përfaqësuesve kyç nga organizatat e shoqërisë civile, dhe anëtarëve të strukturave rinore të subjekteve politike, lidhur me rolin e rinisë në subjektet politike dhe organizatat rinore, dhe përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse.

Të anketuarit e këtij studimi vlerësuan si të rëndësishëm përfshirjen e rinisë në subjektet politike, megjithatë, rreth 90 përqind e të anketuarave nuk ishin aktualisht anëtarë të ndonjë strukture rinore të ndonjë subjekti politik apo organizate rinore. Të anketuarit kishin më tepër gjasa të jenë, apo të kishin qenë, anëtar të një subjekti politik sesa ndonjë lloj tjetër të organizatave të shoqërisë civile. Përfitimet personale ishin përgjigjet kryesore nga rinia e anketuar kur janë pyetur për përfitimet e anëtarësimit në subjektet politik, posaçërisht në lidhshmëri me sigurimin e punësimit

Ka një proporcion pothuaj të barabartë të të anketuarve të cilët besojnë se mundësitë për rininë që të marrin pjesë në proceset vendim-marrëse të subjekteve politike janë të kënaqshme (40%), me ata që besojnë se mundësi të tilla janë të pakënaqshme (38%). Mbi një e katërta e të anketuarave theksuan që nuk ka parti politike që ka ideologji të përafërt me pikëpamjet e tyre.

Kishte pajtim të konsiderueshëm me këto pikëpamje të shprehura në intervista me përfaqësuesit kyç të OSHC të angazhuara me rininë dhe subjektet politike. Ata gjithashtu theksuan se nxitja kryesore për rininë për t'ju bashkangjitur subjekteve politike ishte gjetja e punësimit, mirëpo që kjo mund të mos ishte një pritje reale përveç në rastin e udhëheqësve rinor brenda subjekteve politike. Sipas këtyre përfaqësuesve të OSHC roli i strukturave rinore përbrenda subjekteve politike është në përgjithësi simbolik, dhe se nga rinia kërkohet vetëm të kryhen detyra minimale administrative. Përshtypja e tyre e përgjithshme lidhur me strukturat rinore ishte se këto janë struktura të krijuara për të rekrutuar anëtarë të ri dhe të sjellin vota për subjektet politike, dhe se kanë pak apo aspak ndikim në proceset vendim-marrëse.

Rinia përbrenda subjekteve politike e cila është intervistuar duket të jetë e kënaqur me përfshirjen e tyre në subjektet politike dhe në proceset vendim-marrëse. Në përgjithësi, të rinjtë të cilët janë anëtarë të subjekteve politike theksuan se u ishin bashkangjitur strukturave rinore për të ndryshuar situatën e tanishme politike, të ndihmonin komunitetin e tyre, t'i afroreshin politikës dhe liderëve të cilët i idolizojnë. Përshkrimet e të intervistuarve tregojnë që strukturat rinore veprojnë në mënyra të ndryshme tek tri subjektet politike – PDK, AAK dhe NISMA – ku ata ishin të anëtarësuar. Rinia nga këto subjekte politike duket të jetë e angazhuar në aktivitete të ndryshme rekreative, humanitare dhe arsimore. Strukturat rinore të subjekteve opozitare duket të jenë gjithashtu të angazhuara në organizimin e protestave të cilat janë zhvilluar së fundmi.

Ka ngjashmëri si dhe dallime në pikëpamjet e këtyre tri grupeve. Të gjitha tri grupet duket ta pranojnë rëndësinë e anëtarësimit të rinisë në subjektet politike, dhe faktin se rinia ka potencial të luaj një rol të konsiderueshëm përbrenda këtyre subjekteve. Strukturat rinore të subjekteve politike në përgjithësi konsiderohen si mekanizma të duhur përmes të cilëve rinia mund të ushtrojë një rol, edhe pse përfaqësuesit e shoqërisë civile shprehen dyshimin e tyre lidhur me rolin e tanishëm të rinisë përbrenda subjekteve politike. Perceptimi në mesin e të rinjve të anketuar dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të intervistuar është se ka një lidhje të ngushtë në mes anëtarësimit në një subjekt politik dhe mundësive për punësim. Megjithatë, punësimi nuk ishte cekur si arsye për anëtarësim nga anëtarët e intervistuar strukturave rinore të subjekteve politike.

Përfaqësuesit kyç të shoqërisë civile ishin kryesisht të pakënaqur me rolin e rinisë në subjektet politike, ndërsa të rinjtë e anketuar ishin pothuaj barabartë të ndarë në ata që ishin të kënaqur me ata të pakënaqurit. Megjithatë, vetë anëtarët e subjekteve politike u shprehen të kënaqur me përfshirjen e tyre. Qëndrimet e këtyre palëve ishin të ngjashme lidhur me rolin e rinisë në vendim-marrje. Rinia e anketuar dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të intervistuar, vënë në pyetje nivelin e përfshirjes aktuale të strukturave rinore në proceset vendim-marrëse të subjekteve politike dhe nëse këtyre ju caktohen role të vlefshme. Në anën tjetër, rinia përbrenda strukturave rinore të subjekteve politike të cilët janë intervistuar pohonin se ishin mjaftueshëm të përfshirë në proceset vendim-marrëse, edhe pse natyra e aktiviteteve që ata zbatojnë nuk ishte gjithmonë e një natyre politike.

F. Rekomandime

Bazuar në gjetjet e këtij hulumtimi, janë disa veprime kyçe që subjektet politike mund t'i ndërmarrin për të ngritur pjesëmarrjen e rinisë në strukturat e tyre:

- Të nxiten më shumë të rinjtë që të bëhen dhe mbesin anëtarë, duke ofruar detyra të rëndësishme që ata t'i zbatojnë;
- Të informohen të rinjtë lidhur me mundësitë dhe përfitimet nga angazhimi në subjekte politike;
- Të ofrohen mundësi që të rinjtë të udhëheqin dhe zbatojnë iniciativa dhe projekte vullnetare;
- Të organizohen trajnime të rregullta dhe programe për të ngritur njohuritë e anëtarëve të strukturave rinore, dhe pajisja e tyre me shkathtësi profesionale të nevojshme që ndikojnë në jetën e tyre profesionale apo politike;
- Të ndahen fonde të mjaftueshme për ngritjen e kapaciteteve të rinisë dhe zbatimin e projekteve të udhëhequra nga rinia; dhe
- Të sigurohet që pikëpamjet e rinisë vendosen në rend të parë, përmes konsultimeve kuptimplota dhe të rregullta me anëtarët e strukturave rinore, tek politikat e subjektit politik.

G. Shembuj të Rinisë Aktive

Irlanda: Projekti 321 ishte zhvilluar si përgjigje në shqetësimet e rinisë se pse nuk po përfshihej në proceset demokratike. Para zgjedhjeve lokale dhe Evropiane të vitit 2004, secili shërbim lokal rinor i ftoi të rinjtë për një ditë konsultimi për të shqyrtuar çështjet që ndikonin tek ta dhe për të vendosur lidhur me hapat që ata donin të i ndërmerrnin. Rinia formoi nën-komisione. Një grup bëri një video, një grup tjetër zhvilloi një fletë informative, dhe grupi i tretë organizoi një forum të hapur në të cilin ishin ftuar të gjithë kandidatët në zgjedhje. Ky forum ishte i suksesshëm pasi që 70 përqind e kandidatëve morën pjesë. Duke përdorur një format të “takimeve të shpejta”, secili kandidat kaloi 10 minuta me secilin nën-grup duke diskutuar për çështjet e ngritura dhe sa kishin ata vullnet të i trajtonin shqetësimet e rinisë nëse do të i fitonin zgjedhjet.²

Jordani: Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) ka iniciuar trajnime me qëllim të krijimit të një lidhjeje në mes rinisë dhe qeverive lokale, dhe ngritjes së vetëdijesimit lidhur me mundësitë e pjesëmarrjes në politikë. UNDP ka mbështetur Ministrinë e Zhvillimit Politik (MZHP) për të rritur angazhimin e vetë me rininë përmes Facebook dhe Twitter, me qëllim të lehtësimit të diskutimit online. UNDP gjithashtu përkrahu MZHP për të zhvilluar një databazë online të grupeve rinore që t’ju paraqiten atyre në mënyrë më sistematike të dhëna nga grupet rinore lidhur me mënyrën e nxitjes së pjesëmarrjes rinore në jetën politike të vendit. Është zhvilluar një kamp inovacioni për rininë, me elemente si zgjedhje të simuluar, dhe trajnime interaktive mbi fjalimet publike, përdorimin e mediave shoqërore për zhvillim si dhe shkathtësi tjera profesionale. Një partneritet me Princess Samara University for Technology, është duke e mbështetur zhvillimin e një loje për qeverisje lokale për ta kyçur rininë online.³

Kyrgystan: Që nga viti 2000, me mbështetjen e USAID, IFES ka zhvilluar mbi 20 Kampe të Demokracisë në gjithë Kyrgystanin. Pjesëmarrësit nga shkollat e mesme mësojnë për vlera demokratike, shkathtësi udhëheqëse, punë ekipore, rolin e tyre si qytetar, dhe se si të promovojnë ndryshime në shoqërinë e tyre. Në vitin 2009, mbi 2,600 student aplikuan për të marrë pjesë në këto kampe. Qëllimi i këtij projekti është që të ndërtohet një mendim qytetar dhe angazhimi në mesin e gjeneratave të reja, dhe të rritin vetëbesimin e tyre në lidhje me kapacitetet e tyre si individ për të përmirësuar komunitetet dhe vendin e tyre. Ky është një hap i nevojshëm në ndërtimin e një kulture më demokratike në Kyrgystan.⁴

Liban: Programi i Parlamentit Libanezë për Praktikantë ishte zhvilluar për t’ju ofruar studentëve libanezë një mundësi për të marrë pjesë në vendim-marrje publike. Programi ofron trajnime mbi mjetet e politik bërjes publike, dhe i njofton studentët me funksionin legjislativ dhe mbikëqyrës të parlamentit. Ky program krijoi një sistem bashkimi duke i lidhur studentët e universitetit me anëtarët e parlamentit, dhe mbajti një konferencë të përbërë nga të rinj dhe gra nga partitë politike për të diskutuar tranzicionin demokratik në Liban.⁵

² CSSP (2007) “Kyçja e rinisë në Vendim Marrjen e Komunitetit” f.13

³ Rinia e Kombeve të Bashkuara (2013) “Pjesëmarrja e Rinisë në Politikë dhe Vendim – Marrje” f.3

⁴ www.IFES.org

⁵ Rinia e Kombeve të Bashkuara (2013) “Pjesëmarrja e Rinisë në Politikë dhe Vendim – Marrje” f.4

Holanda: Në qytetin Tilburg, ambasadorët rinor përshkruhen si “njerëz të ri me ide të cilët dëshirojnë të inkurajojnë idetë e të rinjve tjerë.” Qyteti ndihmon nxitjen e ideve të tyre me një buxhet prej rreth 40,000 Euro për vit, për t’i mbështetur propozimet e paraqitura nga të rinjtë. Një person i ri mund ta prezantojë një ide me shkrim dhe të marr deri në 2,000 Euro për zbatimin e planit të tij apo saj. Ambasadorët rinor i ftojnë të rinjtë tjerë për të folur lidhur me planet e tyre dhe pastaj të vendosin cilat propozime të i financojnë. Çdo vit, të rinjtë paraqesin më shumë se 50 ide, sikur debate, turnirë të futbollit në palestra të mbyllura, ndonjë film që ata dëshirojnë ta bëjnë, një ngjarje që ata dëshirojnë ta organizojnë.⁶

Mbretëria e Bashkuar (MB): Programi i Parlamentit Rinor i Mbretërisë së Bashkuar (PRMB) synon të fuqizojë të rinjtë e moshave 11 deri 18 vjeçare duke u dhënë atyre mundësinë që të ndikojnë në qeverisjen kombëtare dhe lokale. Disa prej mënyrave se si ata e bëjnë këtë është duke grumbulluar pikëpamjet dhe mendimet nga rinia dhe këshillat e shkollave dhe organizatave vullnetare, dhe duke komunikuar rregullisht me qeveritë e tyre lokale dhe me Anëtarin e tyre të Parlamentit. PRMB synon të promovojë debate dhe fushata mbi çështje, si për shembull, tarifën e shkollimit, biletat e autobusëve dhe përfaqësimin e të rinjve në media, të cilat trajtohen si relevante për të rinjtë në MB. E udhëhequr nga të rinjtë për të rinjtë, PRMB u jap zë të rinjve të MB e moshave 11 deri në 18 vjeçare, i cili dëgjohet nga qeveritë lokale dhe ajo kombëtare.⁷

Këshilla për përfshirje të rinisë

“Shmanguni nga përfaqësimi simbolik: Përfshini të rinjtë në numra të mjaftueshëm e jo vetëm simbolik. Shpeshherë, njerëzit apo organizatat përpiqen të kyçin rininë duke i bërë pyetje vetë disa individëve, duke shtuar një numër simbolik të të rinjve në bordet vendim-marrëse, apo duke përfshirë disa të rinj në aktivitete të caktuara. Të rinjtë i dallojnë përpjekjet simbolike. Ata duhet të përfshihen në numra adekuat dhe të kenë role të vërteta për të qenë pjesëmarrës autentik.

Përfshirja e rinisë që nga fillimi: Sjellja e të rinjve në minutë të fundit mund ta fundos një iniciativë. Jo vetëm që do të duket simbolike, por dështon edhe në sigurimin e kontributit të tyre të vlefshëm. Kur rinia përfshihet nga fillimi, gabimet mund të shmangen, strategji më të suksesshme mund të zhvillohen, dhe ndjenja e pronësisë nga rinia dhe mbështetja e rinisë mund të zhvillohet. Të rinjtë kanë më tepër gjasa të mbesin të kyçur dhe të jenë pozitiv lidhur me punën që realizohet.

Ndaje kohën për angazhimin dhe përfshirjen e plotë të rinisë: Ndonjëherë organizatat, zyrtarët dhe komunitetet – që shpesh punojnë nën një afat financiar apo administrativ – nxitojnë që të fillojnë dhe të zbatojnë një projekt. Ndërmarrja e hapave për të angazhuar rininë në mënyra domethënëse dhe përfshirja e tyre e vazhdueshme mund të marrë shumë kohë.”

Burimi: Qendra për Studim të Politikës Shoqërore (2007) *Kyçja e rinisë në Vendim Marrjen e Komunitetit*, f.41

⁶ Qendra për Studim të Politikave Shoqërore (2007) *“Kyçja e rinisë në Vendim Marrjen e Komunitetit”* p.41

⁷ Shkolla Londineze e Ekonomisë (LSE) – Ndërmarrje (2013, Shkurt) *“Pjesëmarrja e Rinisë në Jetën Demokratike”* f.49

Shtojca I: Ekstrakte nga ligji i Kosovës

Në vitin 2009 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë i cili synon të promovojë dhe riafirmojë pjesëmarrjen e vazhdueshme të rinisë në proceset vendim-marrëse. Disa prej neneve relevante me temën e këtij raporti janë paraqitur në tabelën vijuese. Në pajtim me ligjin, Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit miratoi disa udhëzime administrative të cilat synojnë të rregullojnë organizatat rinore, vullnetarizmin rinor, këshillat rinore, dhe aktivitetet jo-formale arsimore.

Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë	
Neni 6 Përgjegjësitë e organeve të pushtetit qendror	1. Organet e pushtetit qendror, në pajtim me Këshillin e veprimit të rinisë të Kosovës, mbajnë përgjegjësi: 1.1. për zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e dokumenteve përkatëse të sektorit të rinisë; 1.2. për zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të tjera rinore; 1.3. për zhvillimin e procedurave dhe kritereve për avancimin dhe njohjen e punës vullnetare dhe të formave të tjera të veprimtarive të rinisë; 1.4. për mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave për pozitën e të rinjve; 1.5. për mbështetjen e programeve për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e rinisë; 1.6. për ofrimin e informacioneve dhe të konsultimeve të rregullta me të rinjtë lidhur me politikat dhe programet rinore në vend dhe programet e këmbimit rinor ndërkombëtar; 1.7. për mbështetjen e integritetit dhe të pjesëmarrjes në shoqëri të grupeve të marginalizuara nëpërmjet programeve dhe fushatave; 1.8. për sigurimin e strukturave dhe të procedurave që garantojnë pjesëmarrjen e rinisë dhe partneritetin ndërmjet organizatave rinore dhe Qeverisë.[...]
Neni 7 Përgjegjësitë e organeve të pushtetit komunal	1. Organet e pushtetit komunal kanë përgjegjësi: 1.1. për t'u përkujdesur për sigurimin e resurseve njerëzore dhe financiare për realizimin e programeve të rinisë; 1.2. për t'u përkujdesur për sigurimin e hapësirës së duhur publike në konsultim me këshillin e veprimit të rinisë të komunës, ku të rinjtë planifikojnë, udhëheqin dhe zhvillojnë veprimtaritë e tyre rinore dhe edukimin joformal; 1.3. për mbështetjen e organizatave rinore për edukim joformal dhe për veprimtari të tjera zhvillimore të iniciuara nga të rinjtë; 1.4. për zhvillimin e politikave rinore lokale në konsultim me këshillin e veprimit të rinisë të komunës, në përputhje me nevojat lokale; 1.5. për sigurimin e një procesi transparent gjatë angazhimit të menaxhmentit për qendrën e licencuar publike rinore nga komuna përkatëse.
Neni 13 Pjesëmarrja e të rinjve në politikat sektoriale	1. Institucionet e Kosovës, secila në fushëveprimin e vet, sigurojnë pjesëmarrje të të rinjve dhe ndikim në procesin e vendimmarrjes. 2. Pjesëmarrja e të rinjve në politikat sektoriale bëhet në këto fusha: 2.1. arsim; 2.2. punësim; 2.3. shëndet publik; 2.4. çështje sociale; 2.5. kulturë, sport dhe rekreacion; 2.6. edukim qytetar dhe demokraci; 2.7. ambient, planifikim hapësinor dhe zhvillim rural.

Shtojca II: Të referuarit në rininë tek statutet e subjekteve politike

Ekstraktet nga statutet e subjekteve më të mëdha politike, PDK, LDK, AAK dhe NISMA, të cilat i referohen funksionimit të strukturave rinore dhe pjesëmarrjes së rinisë në proceset vendim-marrëse të subjektit politik janë paraqitur në tabelën vijuese. Nuk ishte gjetur referim në rininë apo struktura rinore tek statuti i VV-së.

PDK Partia Demokratike e Kosovës (Statuti 2005)	Neni 7 Mënyra e organizimit 7.5 Në kuadër të PDK-së funksionon Organizata e Gruas Demokratike dhe Organizata e Rinisë Demokratike, të organizuara në nivelin e Degëve dhe nivelin qendror të Partisë. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tyre përcaktohet me rregullore të veçanta, të cilat i miraton Këshilli Drejtues. RDK dhe GDK përfaqësohen në strukturat e Partisë së paku me 20. Neni 26 Kryesia e Partisë 26.10 Anëtarë të Kryesisë me të drejtë vote, sipas funksionit, janë edhe Kryetarja e GDK-së dhe Kryetari i RDK-së.
LDK Lidhja Demokratike e Kosovës (Statuti 2012)	Neni 18 Kuvendi i LDK-së 18.3 Me rastin e zgjedhjes së delegatëve për Kuvend, secila degë siguron përfaqësimin e femrave dhe të rinjve. Neni 29 Kryesia 29.3 Kryetari i LDK-së, Kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit të Rinisë janë anëtarë të Kryesisë. Neni 38 Forumet, Këshillat dhe Grupet e Interesit të LDK-së 38.4 Në Forumin Rinor të LDK-së organizohen të rinjtë nga moshë 16 deri në moshën 26-vjeçare. Neni 45 Kryesia e Degës 45.3 Anëtarë të Kryesisë së Degës janë edhe kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit të Rinisë.
AAK Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës Statuti	Neni 37: Aleanca e të Rinjve të Kosovës (ARK) 1. Të rinjtë në AAK mund të jenë të organizuar edhe në ARK; 2. ARK e ka strukturën e vet të mëvetësishme organizative. Për organizimin dhe strukturimin e ARK-së, organet e saj i nxjerrin aktet e tyre, të cilat duhet të jenë në pajtim me frymën e këtij Statuti dhe të Programit të AAK-së; 3. Anëtarët e ARK-së kujdesen për mbështetjen dhe zbatimin e politikës së përcaktuar nga Kuvendi, Këshilli Drejtues, Kryesia e Zgjeruar dhe Kryesia e ARK-së dhe AAK-së; 4. ARK e ka Rregulloren dhe Programin e punës, në përputhje me frymën e Statutit dhe me Programin e AAK-së; 5. ARK i zgjedh të gjitha organet udhëheqëse në Kuvendet e veta, me mandat trevjeçar dhe me të drejtë në jo më shumë se një mandat të ri-zgjedhjes; 6. Kuvendi Zgjedhor i ARK-së mbledhet një herë në tre vjet ndërsa Kuvendi i Jashtëzakonshëm mbahet sipas nevojës. Neni 38: Anëtarësia në ARK 1. Anëtarë të ARK-së mund të jenë qytetarët e moshës deri në 30 vjeç. 2. Organet udhëheqëse të ARK-së janë përgjegjëse për: 3. Përfshirjen dhe përparimin sa më të madh të të rinjve në AAK; 4. Strukturimin dhe fuqizimin e ARK-së dhe 5. Punën me degët e ARK-së. Neni 39: Kryetari i ARK Sipas pozitës, Kryetari i ARK-së është anëtar i Kryesisë së AAK-së dhe është përgjegjës për: 1. Punën e ARK-së në përputhje me Statutin dhe me Programin e AAK-së, rregulloren dhe të programin e punës së ARK-së;

	2. Bashkërenditjen e veprimeve ndërmjet ARK-së dhe AAK-së dhe përfaqësimin e interesave të ARK-së në strukturat e AAK-së.
NISMA (Statuti 2015)	Neni 9 Organizimi i NISMA-së për Kosovën 6. Në kuadër të NISMA për Kosovën në tri nivelet e saja të organizimit funksionon edhe organizata e NISMA e Gruas për Kosovën dhe NISMA e Rinisë për Kosovën. Neni 13 Këshilli i Degës 3. Po ashtu anëtarë të Këshillit të Degës janë të gjithë kryetarët e nën degëve, deputetët e parlamentit nga komuna përkatëse, të zgjedhurit në asamble, të emëruarit në organet e Qeverisjes Lokale, kryetarja e gruas në degë dhe kryetari i rinisë në degë. Neni 17 Këshilli Kombëtar i NISMA-së 3. Anëtarë të Këshillit Kombëtar sipas detyrës janë: Kryetari i NISMA, Kryetarët e Degëve, Kryetarja e gruas, Kryetari i rinisë, Deputetët e NISMA-së në Kuvendin e Kosovës [...]. Neni 18 Kryesia e NISMA 1. Kryesia e NISMA-së përbëhet nga një numër tek anëtarësh, duke përfshirë Kryetarin, Kryetarin e KK, Sekretarin e Përgjithshëm, Kryetarin e Rinisë së NISMES, Kryetaren e Gruas së NISMËS [...].

Shtojca III: Lexim plotësues

Burimet Kosovare:

- Ligji mbi Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2009, i qasur në Qershor 2016 tek <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009-145-eng.pdf>
- Udhëzimi Administrativ 04/2015 për Edukim Joformal të Rinisë, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i qasur në Qershor 2016 tek http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/UA_04-2015_per_edukimin_joformal_te_te_rinjve.pdf
- Udhëzimi Administrativ 11/2010 për Regjistrimin e Qendrave Rinore, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i qasur në Qershor 2016 tek http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/U.A._Nr._11-2010_per_regjistrimin_e_Qendrave_Rinore.pdf
- Udhëzimi Administrativ 10/2010 për Punën Vullnetare të Rinisë, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i qasur në Qershor 2016 tek http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/U.A._Nr._10-2010_per_punene_vullnetare_te_te_rinjve.pdf
- Udhëzimi Administrativ 09/2010 për Përgjegjësitë dhe Procedurat për Themelimin dhe Funkcionimin e Këshillave Rinor për Veprim në Kosovë, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i qasur në Qershor 2016 tek http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/U.A._Nr._9-2010_per_pergjegjesite_dhe_procedurat_e_themelimite_te_Keshillave_te_Veprimit_Rinor_ne_Kosove.pdf
- “Strategjia Kosovare për Rini 2013-2017”, lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2013), i qasur në Qershor 2016 tek https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/KOSOVO_STRATEGY_FOR_YOUTH.pdf
- “Doracaku për pjesëmarrje të këshillave lokal të veprimit të rinisë” lëshuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2013), i qasur në Qershor 20016 tek at <http://www.osce.org/kosovo/110054?download=true>

Burimet Ndërkombëtare:

- Rinia e Kombeve të Bashkuara (2013) “Pjesëmarrja Politike e Rinisë dhe Vendim – Marrja”, i qasur në Qershor 2016 tek <http://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact->

sheets/youth-political-participation.pdf

- Shkolla Londineze e Ekonomisë (LSE) (2013) *“Pjesëmarrja Rinore në Jetën Demokratike”*, i qasur në Qershor 2016 tek <http://www.lse.ac.uk/businessAndConsultancy/LSEEnterprise/pdf/YouthParticipationDemocraticLife.pdf>;
- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) (2013) *“Rinia, Pjesëmarrja Politike dhe Vendim-Marrja”*, i qasur në Qershor 2016 tek <http://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-political-participation.pdf>
- Qendra për Studimin e Politikës Shoqërore *“Kyçja e rinisë në Vendim Marrjen e Komunitetit”*, i qasur në Qershor 2016 tek <http://www.cssp.org/community/constituents-co-invested-in-change/other-resources/engaging-youth-in-community-decision-making.pdf>;
- Këshilli i Evropës (2003) *“Karta e Reviduar Evropiane mbi Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale”*, i qasur në Qershor 2016 tek http://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Coe_youth/Participation/COE_charter_participation_2013_en.pdf
- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) *“Përmirësimi i Pjesëmarrjes Politike të Rinisë përgjatë Ciklit Elektorale”*, i qasur në Qershor 2016 tek http://www.undp.org/content/dam/undp/library/Democratic%20Governance/Electoral%20Systems%20and%20Processes/ENG_UN-Youth_Guide-LR.pdf.